

Për:	Operatorë Ekonomik: Hidroterm SH.P.K. me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **09.06.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K. me adresë në Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K. me adresë në Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.05.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, **duke përdorur formularin B54***
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik **për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **22.05.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **09.06.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Ak-Rahoves ka inicuar aktivitetin e prokurimit: NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC, me numër prokurimi 623-23-2255-5-1-1 dhe nr. I mbrendshem 623-23-031-5-1-1

Te kapaciteti Teknik dhe professional në pikën 2.7 keni kërkuar: Master në Menaxhimin e Emergjencave- me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, (I njëjti të jetë i certifikuar në lëmin mbrojtja nga zjarri dhe fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë).

Konsiderojm se kjo kërkesë bien ë kundërshtim në kualifikimin universitar si Master I Kësaj fushe, pasi që I kualifikuari në nivelin Master në Menaxhimin e Emergjencave mbulon dhe tejkalon këtë certifikatë të kërkuar, po ashtu ju kujtojmë se niveli I këtij kualifikimi është staf trajnues në dhënien e këtyre certifikatave.

Andaj kërkojmë nga ju që këtë kërkesë të ndryshoni dhe të largoni kërkesën mbi certifikatën në lëmin e mbrojtja nga yjarri dhe fusha e sigurisë .

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

2.7. Master në Menaxhimin e Emergjencave - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet te jetë i certifikuar ne lëmin mbrotja nga zjarri dhe nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë);

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,

Korrigjohet në:

2.7. Master në Menaxhimin e Emergjencave - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit; (i njëjti duhet te jetë i certifikuar ne lëmin nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë)

Për këtë aktivitet të prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes së Tenderit - (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në lëmin mbrotja nga zjarri);

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit